



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr. 99, datë 19.05.2022

**“PËR PLOTËSIMIN E NJË VAKANCE TË PËRKOHSHME NË PROKURORINË
PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË GJIROKASTËR, NËPËRMJET
PROCEDURËS SË TRANSFERIMIT TË PËRKOHSHËM ME PËLQIM”**

Bazuar në nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 46, të ligjit Nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, në nenet 5 dhe 6, të Rregullores “Mbi Kriteret dhe Procedurën e Transferimit të Përkohshëm të Prokurorit”, si dhe në relacionin shpjegues të përgatitur nga Komisioni për Zhvillimin e Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Të njoftojë fillimin e procedurave për plotësimin e një vakance të përkohshme, nëpërmjet procedurës së transferimit të përkohshëm me pëlqim, për një periudhë 6 (gjashtë) mujore, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastrë.
2. Subjektet të cilët kanë të drejtë të kandidojnë, kriteret që duhet të plotësojnë, afati i dorëzimit të shprehjes së interesit, dokumentacioni që duhet të dorëzojnë dhe adresa ku do të dorëzohet shprehja e interesit, do të njoftohen në faqen zyrtare të Këshillit.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare web të Këshillit.
4. U shpall në Tiranë, sot më 19.05.2022.

KRYETARI
ALFRED BALLA

